



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

MBI GRANTET E OFRUARA NGA QEVERIA E KATARIT PËR STUDIME NË FUSHËN E SIGURISË USHQIMORE

Fondi Kombëtar për Kërkimin Shkencor i Katarit në bashkëpunim me Ministrinë e Bashkive dhe Mjedisit ofron mundësi aplikimi për studime në fushën e sigurisë ushqimore për universitetet dhe qendrat kërkimore shqiptare.

Në kuadër të strategjisë gjithëpërfshirëse të Katarit, këto grante synojnë pasurimin e dijeve bazuar në zhvillimet ekonomike duke inkurajuar kulturën për kërkimin shkencor, si dhe duke siguruar mbështetjen teknike dhe financiare për të promovuar ekonominë nëpërmjet mbështetjes së industrisë ushqimore dhe inkurajimit të prodhimit në këtë sektor. Ndihmës Nënsekretari për çështjet e bujqësisë dhe peshkimit pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Peshkimit dhe Ministrisë së Bashkive dhe Mjedisit, Dr. Faleh bin Nasser Al Thani, njofton gjithashtu se Universitetet shqiptare mund të përfitojnë grante nga Fondi Kombëtar i Katarit.

Nëse është me interes nga ana juaj, lutemi referojuni informacionit bashkëlidhur, si dhe faqes web të Fondit për Mundësitë e Financimit të Kërkimeve dhe të Fondacionit Kombëtar për Kërkime Shkencore (Facility for research Funding Opportunities): www.qnrf.org

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS